



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.4, datë 10.02.2022

PËR

“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT:
“PLANI I PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 10.02.2022, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të Drejtorisë Teknike, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Për miratimin për Këshillim Publik të dokumentit: “Plani i Përdorimit të Frekuencave”.*

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ë) e nenit 8, pika 2 e nenit 62, neni 64 dhe neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);

2. Plani Kombëtar i Frekuencave, miratuar me VKM Nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (**PKF**);
3. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin nr.21, datë 07/12/2021;
4. Shkronja i), pika 1.2 e nenit 19 të Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: “*Plani i Përdorimit të Frekuencave*”;
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Plani Kombëtar i Frekuencave i miratuar me VKM nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” i cili ka implementuar ndryshimet e pasqyruara në planin ECA (The European Table of Frequency Allocations and Applications) publikuar në qershor 2016, ka sjellë si pasojë që breza të caktuar frekuencash të pësojnë ndryshime në:
 - ndarjen e brezave;
 - përcaktimet ;
 - aplikimet.
2. Ndryshimet e mësipërme duhen reflektuar edhe në Planin e Përdorimit të Frekuencave duke bërë të mundur:
 - Teknikisht dhe ekonomikisht planifikimin optimal, caktimin dhe përdorimin efikas të frekuencave, duke marrë parasysh që spektri i radiofrekuencave dhe orbita gjeostacionare janë në vetëvete burime të rralla dhe të fundme;
 - Përfitim të kushteve për përgatitjen e rregullave mbi kushtet teknike dhe operative për përdorimin e disa frekuencave;
 - Mbrojtjen nga interferencat e dëmshme;
 - Rregullimin e Planit me modifikimet në nivel ndërkombëtar, si edhe bashkërendimet që rezultojnë nga përmbushja e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me fqinjët dhe vendet e tjera;
 - Rregullimin e përdorimit të brezave të frekuencave ndërmjet shërbimeve radio dhe përdoruesve; dhe
 - Implementimin e teknologjive të reja dhe zhvillimin e komunikimeve radio.

3. Drejtoria Teknike ka përgatitur Planin e Përdorimit të Frekuencave i cili përfshin:
- a) brezat e frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF) të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1187, datë 24.12.2020 “**Për miratimin e Planit Kombëtar të frekuencave**” (PKF), për përdorime “civile”, të cilat mund të përdoren për qëllime civile, si dhe zbatimet e shërbimeve radio të përcaktuara në këto breza frekuencash;
 - b) rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e operimit lidhur me operimin e radio sistemeve;
 - c) implementimin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë pësuar brezat për aplikimet GSM, IMT, BWA, etj. si përsa i përket teknologjive të aplikuara në këto breza ashtu edhe shërbimeve të ofruara.
 - d) detaje dhe mënyrën e ndarjes së kanaleve, kanalet e mundshme për caktim, parametrat teknikë që duhet të zbatohen etj.
 - e) kërkesat Teknike të Ndërfaqeve Radio në të cilat përcaktohen kushtet për përdorimin e frekuencave dhe pajisjeve radio. Struktura e tyre përcaktohet në dokumentin, udhëzues të Komisionit Europian: *"Radio and Telecommunications Terminal Equipment (R & TTE), Radio interfaces – List of information elements in Radio Interfaces"* dhe caktimi i shërbimeve radio dhe aplikimi i tyre është sipas dokumentit: *ECC/DEC/(01)03 on Frequency Information System (EFIS)*".
4. Propozimi për miratimin në këshillim publik i Planit të Përdorimit të Frekuencave respekton kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 2 të nenit 64 të ligjit nr. 9918/2008 pasi është hartuar në përputhje me përcaktimet dhe udhëzimet e PKF-së dhe bën përditësimin për brezat dhe nënbrezat për shërbimet e ndryshme të radiokomunikimeve, si dhe përmban parametrat dhe kushtet teknike të përdorimit të frekuencave.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e dokumentit të cituar më lart, në mbështetje të nenit 114 dhe nenin 115, të ligjit nr. 9918, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Plani i përdorimit të frekuencave”, sipas dokumenteve bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditë, nga data e publikimit të dokumentit.

3. Ky vendim dhe dokumenti për këshillim publik të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;
4. Ngarkohet Drejtoria Teknike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Lorenc Bako	Xhoana Lilaj